



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA DURRËS**

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË ___/___/2020

PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN ME QIRA TË TERRENIT SPORTIV, QË PËRFAQËSON DY FUSHA TENISI ME SIPËRFAQE 1420 M²; TË AMBJENTIT GODINË 1KT ME SIP. 32.4 M² DHE TË SIP.124.6M², QË PËRSHIN SHKALLËT BETONARME DHE NDËRTIME TË RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS (KANALIZIME DHE SIP. TË GJELBËRUARA), QË JANË NË FUNKSION TË TERRENIT SPORTIV, ME VENDNDODHJE NË TERRITORIN E GJIMNAZIT “LEONIK TOME0” PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 5-VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, ligjit Nr. 79/2017 “Për sportin”, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Për Qiranë”, shkresës nr. 563/1, datë 28.05.2018, ardhur nga Gjimnazi “Leonik Tomeo”, sipas Relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ligjore, AKRSKF dhe Burimeve Njerëzore, zëvendëskryetari i bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin për dhënien me qira të terrenit sportiv, që përfaqëson dy fusha tenisi me sipërfaqe 1420 m²; të ambjentit godinë 1KT me sip. 32.4 m² dhe të sip.124.6m², që përfshin shkallët betonarme dhe ndërtime të rrjetit të infrastrukturës (kanalizime dhe sip. të gjelbëruara), që janë në funksion të terrenit sportiv, me vendndodhje në territorin e gjimnazit “Leonik Tomeo”, pronë e bashkisë Durrës, për një afat 5-vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.
2. Ngarkohet Drejtoria Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA DURRËS**

RELACION

MBI MIRATIMIN PËR DHËNIEN ME QIRA TË TERRENIT SPORTIV, QË PËRFAQËSON DY FUSHA TENISI ME SIPËRFAQE 1420 M², TË AMBJENTIT GODINË 1KT ME SIP. 32.4 M² DHE TË SIP.124.6M², QË PËRFAQËSON SHKALLËT BETONARME DHE NDËRTIME TË RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS (KANALIZIME DHE SIP. TË GJELBËRUARA), QË JANË NË FUNKSION TË TERRENIT SPORTIV, ME VENDNDODHJE NË TERRITORIN E GJIMNAZIT “LEONIK TOMEQ”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 5-VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT.

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU**

Të nderuar këshilltarë!

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim, ka për qëllim fillimin e procedurave për dhënie me qira, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, të terrenit sportiv, që përfaqëson dy fusha tenisi me sipërfaqe 1420 m², të ambjentit godinë 1KT me sip. 32.4 m² dhe të sip.124.6m², që përfaqëson shkallët betonarme dhe ndërtime të rrjetit të infrastrukturës (kanalizime dhe sip. të gjelbëruara), që janë në funksion të terrenit sportiv, me vendndodhje në territorin e gjimnazit “Leonik Tomeo”, pronë e bashkisë Durrës, për një afat 5-vjet.

Pasuritë që kërkohet të jepen me qira janë pronë e bashkisë. Bashkia kohët e fundit, me qëllimin për t'i shërbyer kurrikulës së shkollës, në territorin e shkollës “Leonik Tomeo”, ka ndërtuar 2 fusha tenisi. Vlera e investimit ku përfshihen rrethimi me kangjella, shtresa të fushës (çakull, shtresë betoni, stabilizant, tapet bari artificial, stola, kanalizimi i kullimit të ujrave, ndërtesë, stola, etj.) është 13,211,706 lekë në shkollën “Leonik Tomeo”.

Sqarojmë se ky investim ka patur për qëllim që t'i shërbejë nxënësve të shkollës, por dhe më gjërë, komunitetit të asaj zone.

Kompetencë për dhënie me qira të kësaj pasurie është këshilli bashkiak, në cilësinë e pronarit. Kjo është përcaktuar si në VKM-në nr. 54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, i cili përcakton se “... Pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose enfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit... Pasuritë shtetërore, që jepen me qira janë: ndërtesat, sipërfaqet funksionale (jo nën ndërtesë), trualli i lirë... terrene sportive ... ashtu dhe në ligjin

organik të vetëqeverisjes vendore, në paragrafin *për të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë* përcakton se “... njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...”.

Neni 54 i ligjit “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, gërma “e”, përcakton se Këshilli bashkiak “... miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve... Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit...”.

Ndodhur në këto kushte, me qëllimin e përdorimit të kësaj pasurie si nga nxënësit e shkollës, por dhe të komunitetit përreth, ruajtjen nga degradimi apo konsumimi, mendojmë se mënyra më e mirë është dhënia me qira.

Këtë aktivitet qiramarrësi do ta ushtrojë pas orarit të mësimit, duke mos penguar funksionimin normal të aktiviteteve sportive të shkollës gjatë orarit mësimor.

Gjatë publikimit për marrjen me qira një nga kushtet do të jetë dhe detyrimi i qiramarrësit, që në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, të ofrojë për nxënësit e shkollës, ushtrimin e sportit të tenisit, pa pagesë.

Mendojmë se ushtrimi i aktivitetit sportiv në terrenin sportiv të shkollës, zgjidh këto probleme:

- Do t’i shërbejë procesit mësimor, konkretisht kurrikulës mësimore të orës sportive, duke përmirësuar kështu orët e edukimit fizik, zhvillimit të orës së edukimit fizik sa më komod, përmirësimin e cilësive fizike, teknike, kapacitetin jetësor të çdo nxënësi, me synim rritjen e cilësisë fiziko-sportive.
- Përdorimi i fushës së tenisit nga qiramarrësi do të bëhet pas orarit mësimor.
- Brenda orarit mësimor, në bazë të marrëveshjes që do lidhë bashkia dhe institucioni arsimor, me fituesin e dalë nga konkurrimi do të instruktohen nxënësit për të ushtruar sportin e bukur të tenisit, nga ana e trajnereve, pa pagesë.
- Dhënia në përdorim të terreneve sportive pas orarit të mësimit, do të sjellë dhe përfitime të tjera. Të gjitha shërbimet si për riparimin të tapeteve, sistemit të rrethimit, ndriçimit, etj, do të realizohen nga ana e qiramarrësit.